

Konsultimi publik në Kosovë

Vetëm procedural



*Premtimi i madh i konsultimit publik në Kosovë është që **çdo qytetar, organizatë e shoqërisë civile, biznes, sindikatë, apo çfarëdo entiteti tjetër ka të drejtë të ndikojë në formësimin e politikave publike.***


Megjithatë, në realitet, konsultimi shpesh reduktohet në një proces vetëm formal, në një platformë online me probleme teknike, që rrallë nxit pjesëmarrje domethënëse.



261

draft-politika u publikuan për konsultim në Platformën online për Konsultim Publik në vitin 2024.

Politikat për konsultim janë të ndryshme, nga kalendari i vitit shkollor, strategjia shtetërore kundër korrupsionit, e deri te rregullat për licencimin e administratorëve falimentues.



*(15) Koncept dokumente, (10) Strategji, (9) Plane veprimi, (3) Programe dhe (7) Të tjera

49%

e kontribuesve që komentuan në
Platformën online ishin OShC.

OShC-të vazhdojnë të
*mbesin **kontribuesit***
më aktivë në procesin
e konsultimit publik.



80%

*e draft-politikave të miratuara
në vitin 2024 u publikuan për konsultim
publik në Platformën online, por ...*

Konsultimi **DËSHTOI** të mundësojë:



**Përfshirje të hershme
të publikut**



**Pjesëmarrje përtej
Platformës online**




**Adresim të duhur të
kontributeve të publikut**

[zero]

Publiku nuk përfaqësohet që në fillim të politikbërjes. Takimet publike fillestare nuk zhvillohen fare.

*Gjatë vitit 2024,
nuk u mbajt asnjë takim
fillestar me publikun para
fillimit të hartimit të
draft-politikave.*



1 kanal

**Platforma online mbetet kanali kryesor,
dhe pothuajse i vetëm, për pjesëmarrje
në konsultim publik.**

*Gjatë vitit 2024, problemet teknike
e bënë Platformën online
jofunksionale për një periudhë
të konsiderueshme të vitit,
duke pamundësuar
pjesëmarrjen e publikut.*



46.5%

e rapORTEVE përfundimtare të konsultimit **nuk u publikuan në Platformën online.**

Publiku nuk informohet se çka ndodh me kontributin e tij në konsultim publik.





Konsultimi publik shpesh bëhet vetëm formalisht



Konsultimi ka nevojë për përmirësim



Problemet janë të shumta, teknike dhe përmbajtësore




Ka interesim nga publiku për të marrë pjesë




Shoqëria civile është kontribuesja më e madhe




Platforma online mbetet pothuajse i vetmi mjet për pjesëmarrje




Bëhu pjesë e procesit!



**Konsultimi publik është obligim
dhe ju keni të drejtë
të merrni pjesë!**



**Politikat që vendosen në
konsultim e prekin
jetën tuaj!**



**Mjafton mendimi juaj
për të qenë
pjesëmarrës!**

